

VENDIM
Nr. 19, datë 20.6 2024

BIBLIOGRAFIA E INFORMACIONIT TË DEKLASIFIKUAR NË AIDSSH

Mbështetur në nenin 44, pika 4, të ligjit nr. 45/2015, “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, të ndryshuar; në kreun I, nenin 22, pika 4, të ligjit nr. 10/2023, “Për informacionin e klasifikuar”, të ndryshuar; në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 662, datë 15.11.2017, “Për miratimin e rregullores për deklasifikimin dhe zhvlerësimin e informacionit të klasifikuar ‘Sekret shtetëror’”, Komisioni i Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar ‘Sekret shtetëror’, në AIDSSH, i ngritur me urdhrin nr. 21, datë 6.2.2023, të kryetarit të Autoritetit “Për krijimin e komisionit të deklasifikimit dhe zhvlerësimit të informacionit të klasifikuar ‘Sekret shtetëror’ në AIDSSH”, të ndryshuar, me urdhrin nr. 56, datë 23.3.2023, “Për një ndryshim në urdhrin nr. 21, datë 6.2.2023, ‘Për krijimin e Komisionit të Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar ‘Sekret shtetëror’ në AIDSSH”, ka bërë deklasifikimin e informacionit të klasifikuar “Sekret shtetëror”, me vendimin nr. 19, datë 20.6.2024, si më poshtë:

I. Deklasifikoi plotësisht informacionet e mëposhtme:

1. Arkiva e Autoritetit, Fondi Drejtoria II, dosje nr. 7236 në ngarkim të Q. M., me 2 (dy) fletë. Dosja daton në vitin 1970. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.
2. Arkiva e Autoritetit, Fondi Dega e Punëve të Brendshme Kavajë, dosje personale dhe pune nr. 6204, “I penduari” në ngarkim të H. D., me 163 (njëqind e gjashtëdhjetë e tre) fletë. Dosja daton në vitet 1978–1986. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.
3. Arkiva e Autoritetit, Fondi Dega e Punëve të Brendshme Kavajë, dosje formulare nr. 5664, në ngarkim të H. D., me 104 (njëqind e katër) fletë. Dosja daton në vitet 1976–1991. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.
4. Arkiva e Autoritetit, Fondi 6, Drejtoria e Tretë e Sigurimit të Shtetit, dosje nr. 42, Materiale në ngarkim të arratisurit M. P., me 19 (nëntëmbëdhjetë) fletë. Dosja daton në vitet 1945–1964. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.
5. Arkiva e Autoritetit, Fondi Komiteti Qendror i PPSH-së, dosje nr. 1, Informacione për komente të diplomatëve të huaj, me 222 (dyqind e njëzet e dy) fletë. Dosja daton në vitin 1985. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret”.
6. Arkiva e Autoritetit, Fondi Dega e Punëve të Brendshme Dibër, dosje përpunimi nr. 1066, në ngarkim të A. Gj., me 125 (njëqind e njëzet e pesë) fletë. Dosja daton në vitet 1950–1989. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret”.
7. Arkiva e Autoritetit, Fondi Drejtoria II, Fashikull nr. 95, në ngarkim të H. K., me 42 (dyzet dy) fletë. Dosja daton në vitet 1953–1989. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.
8. Arkiva e Autoritetit, Fondi të Arratisur, Fashikull nr. 2881, në ngarkim të K. R., me 59 (pesëdhjetë e nëntë) fletë. Dosja daton në vitet 1984–1985. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret”.
9. Arkiva e Autoritetit, Fondi të Arratisur, Fashikull nr. 2205 në ngarkim të H. D., me 250 (dyqind e pesëdhjetë) fletë. Dosja daton në vitet 1945–1986. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.
10. Arkiva e Autoritetit, Fondi Drejtoria e Punëve të Brendshme Tiranë, dosje formulare nr. 8365, në ngarkim të P. G., me 180 (njëqind e tetëdhjetë) fletë. Dosja daton në vitet 1968–1990. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.
11. Arkiva e Autoritetit, Fondi Dega e Punëve të Brendshme Kavajë, dosje përpunimi nr. 2492, në ngarkim të L. F., me 47 (dyzet e shtatë) fletë. Dosja daton në vitet 1977–1990. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret”.

12. Arkiva e Autoritetit, Fondi Dega e Punëve të Brendshme Pogradec, dosje formulare nr. 1445, në ngarkim të Sh. Sh., me 16 (gjashtëmbëdhjetë) fletë. Dosja daton në vitet 1982–1987. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.

1. Arsyeja e deklasifikimit të dokumenteve të sipërcituara është:

- Mbështetur në nenin 44, pika 4 të ligjit 45/2015, “Për të drejtën e informimit për Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, të ndryshuar dhe nenin 22, të ligjit nr. 10/2023, “Për informacionin e klasifikuar”, si dhe në vendimin e Autoritetit nr. 31, datë 24.1.2023, pika 1 e dispozitivit.

2. Ngarkohet Sekretari i KDZH-së të bëjë evidentimet përkatëse në regjistër, të vendosë vulën përkatëse mbi dokumentet e deklasifikuara dhe të hartojë bibliografinë e informacionit të deklasifikuar.

3. Kopja e bibliografisë së informacionit të deklasifikuar t’i dërgohet zyrtarisht Autoritetit Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar.

4. Të bëhet publikimi i dokumenteve të deklasifikuar në faqen zyrtare të internetit të AIDSSH-së dhe në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR I KDZH-së
Gentiana Sula